



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 916/ 7 prot.

Datë 08/05/2026

V E N D I M

Nr. 608/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Gjergj Mersini | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 08/05/2026, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*FEDOS*” SHPK, në procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-76050-02-12-2026*, me objekt: “*Blerje letër rulo për shërbimet, kabinetet dhe konsultat e QSUNT, për 24 muaj*”, me fond limit 14,560,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*FEDOS*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-76050-02-12-2026*, me objekt: “*Blerje letër rulo për shërbimet, kabinetet dhe konsultat e QSUNT, për 24 muaj*”, me fond limit 14,560,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Carpathia Albania*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-76050-02-12-2026*, me objekt: “*Blerje letër rulo për shërbimet, kabinetet dhe konsultat e QSUNT, për 24 muaj*”, me fond limit 14,560,000 lekë pa

TVSH, zhvilluar në datën 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*Vitanet Albania*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. REF-76050-02-12-2026, me objekt: “*Blerje letër rulo për shërbimet, kabinetet dhe konsultat e QSUNT, për 24 muaj*”, me fond limit 14,560,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*ISOMETRIC*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. REF-76050-02-12-2026, me objekt: “*Blerje letër rulo për shërbimet, kabinetet dhe konsultat e QSUNT, për 24 muaj*”, me fond limit 14,560,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “*FEDOS*” SHPK me NIPT: K01514009I dhe me adresë: *Rruga “Kujtim Laro”, Nr pasurie 3/22, Kati 2, Tiranë.*

Operatori ekonomik “*BESIM KAMBERI*” P.F me NIPT: L42103023G dhe me adresë: *Rruga e Qelqit, Zona Kadastrale Nr 3866 Nr Pasurie 310/20, Kashar, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor:

Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Subjekte të interesuar:

Operatori ekonomik “*InfoSoft Office*” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: *Autostrada Tiranë - Durrës, Km 8 Tiranë.*

Operatori ekonomik “*FEDOS*” SHPK me NIPT K01514009I dhe adresë: *Rruga “Kujtim Laro”, Nr pasurie 3/22, Kati 2 Tiranë.*

Operatori ekonomik “*Carpathia Albania*” SHPK me NIPT L41629009A dhe adresë: *Rruga “Pavarësia”, Ndërtesa Nr. 1, Kati i Tretë, Zyra 340 dhe magazinë, Mëzez, Tiranë.*

Operatori ekonomik “Vitanet Albania” SHPK me NIPT K92201080V dhe adresë: *Njësia Bashkiake nr 8, Rruga “Siri Kodra”, ndërtesë 2 katëshe , me zonë kadastrale 8340 dhe nr pasurie 8/66, Tiranë.*

Operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK me NIPT L92207009A dhe adresë: *Rruga Dibrës Kompleksi “Arlis” Farmacia 10, shk.2, App. 2, Tiranë.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetura në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit

kanë ankimuar në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm

I.5. Operatori ekonomik ankimues “*FEDOS*” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.6. Operatori ekonomik ankimues “*BESIM KAMBERI*” P.F nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.02.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-76050-02-12-2026*, me objekt: “*Blerje letër rulo për shërbimet, kabinetet dhe konsultat e QSUNT, për 24 muaj*”, me fond limit 14,560,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

II.2. Në datë 02.03.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 13.03.2026 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

| | | | | |
|----|--|------------|------|--------------|
| 1 | “ <i>KRISTALINA.KH</i> ” sh.p.k | 0 | leke | skualifikuar |
| 2 | “ <i>Infosoft Office</i> ” sh.p.k | 9.698.000 | leke | kualifikuar |
| 3 | “ <i>FEDOS</i> ” sh.p.k | 9.984.000 | leke | kualifikuar |
| 4 | “ <i>Carpathia Albania</i> ” sh.p.k | 9.999.600 | leke | kualifikuar |
| 5 | “ <i>Vitanet Albania</i> ” sh.p.k | 10.140.000 | leke | kualifikuar |
| 6 | “ <i>ISOMETRIC</i> ” sh.p.k | 10.660.000 | leke | kualifikuar |
| 7 | “ <i>Besim Kamberi</i> ” Person Fizik | 10.917.400 | leke | kualifikuar |
| 8 | “ <i>AN&RA</i> ” sh.p.k | 10.920.000 | leke | kualifikuar |
| 9 | “ <i>Biotek</i> ” sh.p.k | 10.920.000 | leke | kualifikuar |
| 10 | “ <i>IT Gjergji Kompjuter</i> ” sh.p.k | 10.920.000 | leke | kualifikuar |
| 11 | “ <i>Qendra e Monitorimit te Mjedisit</i> ” sh.p.k | 10.949.000 | leke | kualifikuar |
| 12 | “ <i>O.E.S DISTRIMED</i> ” sh.p.k | 11.440.000 | leke | kualifikuar |
| 13 | “ <i>Malvina Visoka</i> ” Person Fizik | 12.480.000 | leke | kualifikuar |
| 14 | “ <i>Pastrime Silvio</i> ” sh.p.k | 12.947.000 | leke | kualifikuar |
| 15 | “ <i>MARKETING & DISTRIBUTION</i> ” sh.p.k | 14.561.000 | leke | kualifikuar |

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 19.03.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues operatorin ekonomik “*InfoSoft Office*” SHPK.

II.5. Në datën 25.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6454, datë 25.03.2026 dhe numër protokoll nr. 916/2026, datë 25.03.2026 e operatorit ekonomik “*FEDOS*” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*InfoSoft Office*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 916/1, datë 26.03.2026 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*FEDOS*” SHPK, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “*InfoSoft Office*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatori ekonomik “*InfoSoft Office*” SHPK ka paraqitur argumente si subjekt i interesuar, sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, argumente të cilat janë protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 916/2 prot., datë 31.03.2026.

II.8. Në datë 31.03.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 671/13 prot, datë 31.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 916/3 prot, datë 31.03.2026, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “*Vendim KSHA 53/2026*”, datë 31.03.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*FEDOS*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar plotësisht ankesën e ankimuesit.

II.9. Me shkresën nr. 671/13 prot, datë 3.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 916/4 prot, datë 01.04.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “*Vendim KSHA 53/2026*”, datë 31.03.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “*FEDOS*” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar plotësisht ankesën e ankimuesit, duke vendosur si ë poshtë vijon:

“... II.1. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “*FEDOS*” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE “*InfoSoft Office*” shpk, ku argumentohet se: “...Duke mos e patur në aktivitetin e saj tregtimin e pajisjeve mjekësore, kjo shoqëri nuk mund të ketë paraqitur

dëshmi/fatura tatimore shitje për pajisje mjekësore në vlerëri e kërkuar në DST ... ”, KSHA arsyeton se:

...

Duke marrë në konsideratë faturat elektronike të paraqitura nga OE “InfoSoft Office” shpk, rezulton se ky i fundit provon se ka përvojë të ngjashme në furnizimin me artikujt si: “Rul termik, letër me ngjyrë A4, letër fotokopje A4 si dhe rulon letër termike.”

KSHA gjykon se ndërmjet artikujve të sipërcituar dhe letrës rulo për përdorim spitalor ka një diferencë jo vetëm në aspektin formal apo terminologjik, por ky dallim lidhet dhe me natyrën, funksionin si dhe me regjimin juridik të produktit, pasi letra rulo për përdorim spitalor identifikohet si pajisje mjekësore ku i nënshtrohet një kuadri të posaçëm ligjor, si dhe kërkon përmbushjen e standardeve të detyrueshme të sigurisë dhe performancës, përfshirë markimin CE dhe dokumentacionin teknik përkatës.

Për më tepër, letra rulo për përdorim spitalor përdoret në kontakt të drejtpërdrejtë me pacientin, duke ndikuar drejtpërdrejtë në mbrojtjen e shëndetit dhe në parandalimin e infeksioneve, pka i diferencon thelbësisht nga artikujt e deklaruar nga OE “InfoSoft Office” shpk, të cilat nuk i nënshtrohen këtij regjimi të posaçëm dhe nuk kërkojnë të njëjtin nivel përgjegjësie, kontrolli i dhe garantie teknike.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur prej shoqërisë “InfoSoft Office” shpk në funksion të provimit të përvojës së ngjashme nuk plotëson kërkesën për përputhshmëri materiale me objektin e prokurimit, sipas zërave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Mungesa e kësaj përputhshmërie përbën një mangësi thelbësore, e cila ndikon drejtpërdrejtë në vlerësimin e kapacitetit teknik dhe profesional të Operatorit ekonomik.

Barazimi i përvojës në furnizimin e produkteve si rul termik, letër me ngjyrë A4, letër fotokopje A4 apo rulon letër termike me furnizimin me letër rulo (material njëpërdorimësh) për nevoja spitalore do të cenonte thelbin e kriterit të “përvojës së ngjashme”, duke relativizuar kërkesat ligjore dhe duke ulur standardin e sigurisë që synon të garantojë procedura e prokurimit.

Për arsyet e renditura si më lart, si dhe duke marrë në konsideratë objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe dokumentacionin e paraqitur në SPE, KSHA konstaton se shoqëria “InfoSoft Office” shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen në mënyrë kumulative të tre elementëve të përvojës së ngjashme, të parashikuara sipas Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 4.

Për më tepër, pranimi i një oferte që nuk përmbush kriteret e vendosura do të cënonte drejtpërdrejtë parimin e barazisë në kuptim të trajtimit të barabartë të Operatorëve ekonomik si dhe transparencën e procedurës, duke krijuar një avantazh të padrejtë në raport me

Operatorët ekonomik që kanë përmbushur në mënyrë të plotë dhe rigorozë kërkesat e parashikuara nga Autoritetit Kontraktor.

Në përfundim , mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej kritereve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor sjell si pasojë pavlefshmërinë e ofertës, pasi Operatori ekonomik ka detyrimin ligjor të paraqesë dokumentacion të plotë, të saktë dhe në përputhje me dokumentet e tenderit. Çdo devijim nga këto kërkesa përbën shkak të mjaftueshëm për skualifikim.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “FEDOS” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk ku argumentohet se: “...Duke mos e patur në aktivitetin e saj tregtimin e pajisjeve mjekësore, kjo shoqëri nuk është e pajisur as me Autorizim për Tregtim për Pajisje Mjekësore, dokument që është i domosdoshëm për regjistrimin e pajisjes kur kryhet importi i këtij artikulli ” , KSHA arsyeton se:

...

Theksojmë se objekti i prokurimit lidhet me furnizimin me letër rulo për nevoja të QSUNT, ku referuar faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Bamave dhe Pajisjeve Mjekësore (<https://akbpm.gov.al>), Seksioni Regjistri zyrtar i pajisjeve mjekësore i publikuar për periudhën Mars 2026, artikulli “letër rulo për ekzaminim”, identifikohet si më poshtë vijon:

...

Nga sa më lart konstatohet se objekti i procedurës së prokurimit, i cili ka të bëjë me furnizimin me letër rulo për nevoja të QSUNT, referuar regjistrin zyrtar të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (në vijim AKBPM), klasifikohet si pajisje mjekësore, Klasa I, njëpërdorimëshe me funksion të drejtpërdrejtë në procesin e ekzaminimit të pacientëve.

Në këto kushte, evidentohet qartazi se operatori ekonomik i deklaruar si prodhues nuk ka të përfshirë në ekstraktin e tij tregtar fushën e veprimtarisë që lidhet me objektin konkret të prokurimit.

Për rrjedhojë, KSHA gjykon se operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen e kriterit për paraqitjen e Autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për mallin objekt prokurimi.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “FEDOS” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit

ekonomik "InfoSoft Office" shpk ku argumentohet se: "...Duke mos e patur në aktivitetin e saj tregtimin e pajisjeve mjekësore, kjo shoqëri nuk plotëson pikën 5 të kapacitetit teknik.. ", KSHA arsyeton se:

...

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në SPE nga OE "InfoSoft Office" shpk, konstaton se ky i fundit ka deklaruar si prodhues shoqërinë "Rimmed" shpk. Referuar dokumentit Ekstrakt historik të subjektit "Rimmed" shpk rezulton se objekti i aktivitetit lidhet me "Tregti me shumice dhe pakice të mallrave industrial dhe ushqimor elektroshtepiake, elektrike, elektronike, artikuj pastrimi dhe detergjent, artikuj tualeti dhe kozmetik, bare dhe restorante, transport për vetë dhe të tjerët. Prodhimi i letres së aluminit, membranave plastike ushqimore, letres së pjekjes, kartopcetave, letres higjienike, shamiletë etj. Import-Export i tyre".

Referuar Deklaratës së Konformitetit lëshuar datë 24.02.2026, shoqëria "Rimmed" shpk në formën e vetëdeklarimit ndër të tjera ka deklaruar se: "...Produkti në fjalë është material konsumues higjienik njëpërdorimësh dhe nuk klasifikohet si pajisje mjekësore sipas Rregullores (EU) 2017/745 mbi Pajisjet Mjekësore (MDRI, pasi nuk ka funksion diagnostik terapeutik, monitorues apo ndërhyrës mbi pacientin. Për rrjedhojë, produkti nuk i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të konformitetit dhe shënimit CE sipas legjislacionit për pajisjet mjekësore. Kjo deklaratë lëshohet në kuadër të kërkesës për "CE MDC sipas Direktivave/Rregulloreve EU", në përputhje me legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve. ".

Nga sa më sipër, në përputhje me objektin e ushtrimit të veprimtarisë regjistruar sipas ekstraktit tregtar, shoqëria "Rimmed" shpk ka lëshuar deklaratën e konformitetit, ku ndër të tjera citon se objekti i prokurimit është material konsumues higjienik njëpërdorimësh dhe si i tillë nuk klasifikohet si pajisje mjekësore sipas Rregullores (EU) 2017/745 mbi Pajisjet Mjekësore (MDR).

...

Nga sa më lart konstatohet se objekti i procedurës së prokurimit, i cili ka të bëjë me furnizimin me letër rulo për nevoja të QSUNT, referuar regjistrin zyrtar të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Bamave dhe Pajisjeve Mjekësore (në vijim AKBPM), klasifikohet si pajisje mjekësore, Klasa I, njëpërdorimëshe me funksion të drejtpërdrejtë në procesin e ekzaminimit të pacientëve.

Për arsyet e cituara si më sipër, artikulli objekt prokurimi nuk konsiderohet material konsumues higjienik i zakonshëm ashtu siç ka deklaruar shoqëria "Rimmed" shpk, por për shkak të qëllimit dhe funksionit të përdorimit, AKBPM e ka klasifikuar dhe trajtuar si pajisje mjekësore njëpërdorimëshe.

Për rrjedhojë, KSHA gjykon se Operatori ekonomik "InfoSoft Office" shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen e kriterit për paraqitjen e kopjeve të certifikatave përkatëse CE / DC (Deklarate konformiteti) sipas Direktivave/rregulloreve EU, ose certifikim FDA.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.4. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “FEDOS” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk ku argumentohet se: “...Duke marrë parveshje faktet e patur në aktivitetin e saj tregtimin e pajisjeve mjekësore, kjo shoqëri nuk mund të ketë flertifikatën ISO 9001. 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësive” ose ISO 13485. 2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësive për pajisjet mjekësore ” që të përfshijë në fushën e aktivitetit tregtimin e pajisjeve mjekësore... ”, KSHA arsyeton se:

...

Në lidhje me përmbushjen e kërkesës së parashikuar në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2, Operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015 lëshuar në emër të kësaj shoqërie si dhe certifikatën ISO 9001:2015 lëshuar në emër të shoqërisë “Rimmed” shpk të deklaruar si prodhues.

...

Për sa më sipër, KSHA vlerëson se certifikimet e operatorëve ekonomikë, lëshohen në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë të pasqyruar sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar.

Ndodhur në kushtet ku objekti i prokurimit, nuk përfshihet as në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “InfoSoft Office” shpk dhe as në objektin e shoqërisë së deklaruar si prodhues “Rimmed” shpk (fakt ky i evidentuar nëpërmjet Ekstraktit Historik), logjikisht dhe automatikisht objekti i prokurimit nuk përfshihet në objektin e certifikatës ISO 9001:2015.

Në rastin konkret, referuar përmbajtjes së certifikatave ISO 9001:2015 të paraqitura nga shoqëria “InfoSoft Office” shpk, rezulton se fushat e veprimtarisë së pasqyruara në këto certifikata nuk përfshijnë aktivitetin që lidhen me objektin e prokurimit, i cili ka të bëjë në vetvete me furnizim me pajisje mjekësore njëpërdorimëshe konkretisht letër rulo për nevoja spitalore.

Në këtë mënyrë, certifikatat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk përmbushin funksionin provues për të cilin është kërkuar duke mos garantuar në këtë mënyrë kapacitetin organizativ dhe teknik për realizimin e kontratës me sukses.

Në përfundim, KSHA gjykon se duke qenë se kushtet në lidhje me certifikimin duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe të plotë, mospërputhja materiale e fushës së certifikimit me objektin e prokurimit, çënon parimin e proporcionalitetit e për rrjedhojë mosplotësimi i këtij elementi nuk mund të konsiderohet si mangësi formale apo e korrigjueshme.

Për sa më lart, KSHA konstaton se Operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen e kriterit për paraqitjen e Certifikatës ISO 9001:2015 në përputhje materiale me objektin e prokurimit.

Për sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

- 1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “FEDOS” shpk.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”.*

II.10. Në datën 30.03.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6464, datë 30.03.2026 dhe numër protokoll nr. 966/2026, datë 31.03.2026 e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” Person Fizik, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, operatori ekonomik “FEDOS” SHPK, operatori ekonomik “Carpathia Albania” SHPK, operatori ekonomik “Vitanet Albania” SHPK dhe operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.11. Në datë 01.04.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 671/15 prot, datë 01.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 966/1 prot, datë 01.04.2026, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 54/2026”, datë 01.04.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” Person Fizik, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

II.12. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën

dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 966/2, datë 01.04.2026 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Besim Kamberi” Person Fizik, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertave ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, operatori ekonomik “FEDOS” SHPK, operatori ekonomik “Carpathia Albania” SHPK, operatori ekonomik “Vitanet Albania” SHPK dhe operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.13 . Me shkresën nr. 671/15 prot, datë 01.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 966/3 prot, datë 03.04.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 54/2026”, datë 01.04.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Besim Kamberi” Person Fizik, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit.

II.14. Në datë 07.04.2026, operatori ekonomik ankimes “Besim Kamberi” Person Fizik ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentin “Informacion shtesë lidhur me ankesën nr. A/2026/6464” protokolluar me tonën me numër nr. 966/4 prot, datë 07.04.2026, lidhur me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave “Vendim KSHA 54/2026”, datë 01.04.2026, për pretendimet e paraqitura prej ankimesit në ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6464, datë 30.03.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “FEDOS” SHPK për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik ofertues “InfoSoft Office” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Me shkresën nr. 671/13 prot, datë 3.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 916/4 prot, datë 01.04.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, “Vendim KSHA 53/2026”, datë 31.03.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “FEDOS” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e ka pranuar plotësisht ankesën e ankimesit, duke vendosur si ë poshtë vijon:

“... II.1. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimes “FEDOS” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga OE “InfoSoft Office” shpk, ku argumentohet se: “...Duke mos e patur në aktivitetin e saj tregtimin e pajisjeve mjekësore, kjo shoqëri nuk mund të ketë paraqitur

dëshmi/fatura tatimore shitje për pajisje mjekësore në vlerëri e kërkuar në DST ... ”, KSHA arsyeton se:

...

Duke marrë në konsideratë faturat elektronike të paraqitura nga OE “InfoSoft Office” shpk, rezulton se ky i fundit provon se ka përvojë të ngjashme në fumizimin me artikujt si: “Rul termik, letër me ngjyrë A4, letër fotokopje A4 si dhe rulon letër termike.”

KSHA gjykon se ndërmjet artikujve të sipërcituar dhe letrës rulo për përdorim spitalor ka një diferencë jo vetëm në aspektin formal apo terminologjik, por ky dallim lidhet dhe me natyrën, funksionin si dhe me regjimin juridik të produktit, pasi letra rulo për përdorim spitalor identifikohet si pajisje mjekësore ku i nënshtrohet një kuadri të posaçëm ligjor, si dhe kërkon përmbushjen e standardeve të detyrueshme të sigurisë dhe performancës, përfshirë markimin CE dhe dokumentacionin teknik përkatës.

Për më tepër, letra rulo për përdorim spitalor përdoret në kontakt të drejtpërdrejtë me pacientin, duke ndikuar drejtpërdrejtë në mbrojtjen e shëndetit dhe në parandalimin e infeksioneve, pka i diferencon thelbësisht nga artikujt e deklaruar nga OE “InfoSoft Office” shpk, të cilat nuk i nënshtrohen këtij regjimi të posaçëm dhe nuk kërkojnë të njëjtin nivel përgjegjësie, kontrolli i dhe garantie teknike.

Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur prej shoqërisë “InfoSoft Office” shpk në funksion të provimit të përvojës së ngjashme nuk plotëson kërkesën për përputhshmëri materiale me objektin e prokurimit, sipas zërave dhe specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Mungesa e kësaj përputhshmërie përbën një mangësi thelbësore, e cila ndikon drejtpërdrejtë në vlerësimin e kapacitetit teknik dhe profesional të Operatorit ekonomik.

Barazimi i përvojës në fumizimin e produkteve si rul termik, letër me ngjyrë A4, letër fotokopje A4 apo rulon letër termike me furnizimin me letër rulo (material njëpërdorimësh) për nevoja spitalore do të cenonte thelbin e kriterit të “përvojës së ngjashme”, duke relativizuar kërkesat ligjore dhe duke ulur standardin e sigurisë që synon të garantojë procedura e prokurimit.

Për arsyet e renditura si më lart, si dhe duke marrë në konsideratë objektin e veprimtarisë së shoqërisë dhe dokumentacionin e paraqitur në SPE, KSHA konstaton se shoqëria “InfoSoft Office” shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen në mënyrë kumulative të tre elementëve të përvojës së ngjashme, të parashikuara sipas Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 4.

Për më tepër, pranimi i një oferte që nuk përmbush kriteret e vendosura do të cënonte drejtpërdrejtë parimin e barazisë në kuptim të trajtimit të barabartë të Operatorëve ekonomik si dhe transparencën e procedurës, duke krijuar një avantazh të padrejtë në raport me

Operatorët ekonomik që kanë përmbushur në mënyrë të plotë dhe rigorozë kërkesat e parashikuara nga Autoritetit Kontraktor.

Në përfundim , mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej kritereve të vendosura nga Autoriteti Kontraktor sjell si pasojë pavlefshmërinë e ofertës, pasi Operatori ekonomik ka detyrimin ligjor të paraqesë dokumentacion të plotë, të saktë dhe në përputhje me dokumentet e tenderit. Çdo devijim nga këto kërkesa përbën shkak të mjaftueshëm për skualifikim.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “FEDOS” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk ku argumentohet se: “...Duke mos e patur në aktivitetin e saj tregtimin e pajisjeve mjekësore, kjo shoqëri nuk është e pajisur as me Autorizim për Tregtim për Pajisje Mjekësore, dokument që është i domosdoshëm për regjistrimin e pajisjes kur kryhet importi i këtij artikulli ”, KSHA arsyeton se:

...

Theksojmë se objekti i prokurimit lidhet me furnizimin me letër rulo për nevoja të QSUNT, ku referuar faqes zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Bamave dhe Pajisjeve Mjekësore (<https://akbpm.gov.al>), Seksioni Regjistri zyrtar i pajisjeve mjekësore i publikuar për periudhën Mars 2026, artikulli “letër rulo për ekzaminim”, identifikohet si më poshtë vijon:

...

Nga sa më lart konstatohet se objekti i procedurës së prokurimit, i cili ka të bëjë me furnizimin me letër rulo për nevoja të QSUNT, referuar regjistrin zyrtar të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (në vijim AKBPM), klasifikohet si pajisje mjekësore, Klasa I, njëpërdorimëshe me funksion të drejtpërdrejtë në procesin e ekzaminimit të pacientëve.

Në këto kushte, evidentohet qartazi se operatori ekonomik i deklaruar si prodhues nuk ka të përfshirë në ekstraktin e tij tregtar fushën e veprimtarisë që lidhet me objektin konkret të prokurimit.

Për rrjedhojë, KSHA gjykon se operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen e kriterit për paraqitjen e Autorizimit nga prodhuesi ose distributori i autorizuar për mallin objekt prokurimi.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “FEDOS” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit

ekonomik "InfoSoft Office" shpk ku argumentohet se: "...Duke mos e patur në aktivitetin e saj tregtimin e pajisjeve mjekësore, kjo shoqëri nuk plotëson pikën 5 të kapacitetit teknik.. ", KSHA arsyeton se:

...

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e paraqitur në SPE nga OE "InfoSoft Office" shpk, konstaton se ky i fundit ka deklaruar si prodhues shoqërinë "Rimmed" shpk. Referuar dokumentit Ekstrakt historik të subjektit "Rimmed" shpk rezulton se objekti i aktivitetit lidhet me "Tregti me shumice dhe pakice të mallrave industrial dhe ushqimor elektroshtepiake, elektrike, elektronike, artikuj pastrimi dhe detergjent, artikuj tualeti dhe kozmetik, bare dhe restorante, transport për vetë dhe të tjerët. Prodhimi i letres së aluminit, membranave plastike ushqimore, letres së pjekjes, kartopcetave, letres higjienike, shamiletë etj. Import-Export i tyre".

Referuar Deklaratës së Konformitetit lëshuar datë 24.02.2026, shoqëria "Rimmed" shpk në formën e vetëdeklarimit ndër të tjera ka deklaruar se: "...Produkti në fjalë është material konsumues higjienik njëpërdorimësh dhe nuk klasifikohet si pajisje mjekësore sipas Rregullores (EU) 2017/745 mbi Pajisjet Mjekësore (MDRI, pasi nuk ka funksion diagnostik terapeutik, monitorues apo ndërhyrës mbi pacientin. Për rrjedhojë, produkti nuk i nënshtrohet procedurës së vlerësimit të konformitetit dhe shënimit CE sipas legjislacionit për pajisjet mjekësore. Kjo deklaratë lëshohet në kuadër të kërkesës për "CE MDC sipas Direktivave/Rregulloreve EU", në përputhje me legjislacionin për sigurinë e përgjithshme të produkteve. ".

Nga sa më sipër, në përputhje me objektin e ushtrimit të veprimtarisë regjistruar sipas ekstraktit tregtar, shoqëria "Rimmed" shpk ka lëshuar deklaratën e konformitetit, ku ndër të tjera citon se objekti i prokurimit është material konsumues higjienik njëpërdorimësh dhe si i tillë nuk klasifikohet si pajisje mjekësore sipas Rregullores (EU) 2017/745 mbi Pajisjet Mjekësore (MDR).

...

Nga sa më lart konstatohet se objekti i procedurës së prokurimit, i cili ka të bëjë me furnizimin me letër rulo për nevoja të QSUNT, referuar regjistrin zyrtar të publikuar nga Agjencia Kombëtare e Bamave dhe Pajisjeve Mjekësore (në vijim AKBPM), klasifikohet si pajisje mjekësore, Klasa I, njëpërdorimëshe me funksion të drejtpërdrejtë në procesin e ekzaminimit të pacientëve.

Për arsyet e cituara si më sipër, artikulli objekt prokurimi nuk konsiderohet material konsumues higjienik i zakonshëm ashtu siç ka deklaruar shoqëria "Rimmed" shpk, por për shkak të qëllimit dhe funksionit të përdorimit, AKBPM e ka klasifikuar dhe trajtuar si pajisje mjekësore njëpërdorimëshe.

Për rrjedhojë, KSHA gjykon se Operatori ekonomik "InfoSoft Office" shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen e kriterit për paraqitjen e kopjeve të certifikatave përkatëse CE / DC (Deklarate konformiteti) sipas Direktivave/rregulloreve EU, ose certifikim FDA.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues qëndron.

II.4. Lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues “FEDOS” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e Operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk ku argumentohet se: “...Duke marrë parë ne aktivitetin e saj tregtimin e pajisjeve mjekësore, kjo shoqëri nuk mund të ketë flertifikatën ISO 9001. 2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësive” ose ISO 13485. 2016 “Sistemi i Menaxhimit të Cilësive për pajisjet mjekësore ” që të përfshijë në fushën e aktivitetit tregtimin e pajisjeve mjekësore... ”, KSHA arsyeton se:

...

Në lidhje me përmbushjen e kërkesës së parashikuar në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2, Operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015 lëshuar në emër të kësaj shoqërie si dhe certifikatën ISO 9001:2015 lëshuar në emër të shoqërisë “Rimmed” shpk të deklaruar si prodhues.

...

Për sa më sipër, KSHA vlerëson se certifikimet e operatorëve ekonomikë, lëshohen në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë të pasqyruar sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar.

Ndodhur në kushtet ku objekti i prokurimit, nuk përfshihet as në objektin e veprimtarisë së shoqërisë “InfoSoft Office” shpk dhe as në objektin e shoqërisë së deklaruar si prodhues “Rimmed” shpk (fakt ky i evidentuar nëpërmjet Ekstraktit Historik), logjikisht dhe automatikisht objekti i prokurimit nuk përfshihet në objektin e certifikatës ISO 9001:2015.

Në rastin konkret, referuar përmbajtjes së certifikatave ISO 9001:2015 të paraqitura nga shoqëria “InfoSoft Office” shpk, rezulton se fushat e veprimtarisë së pasqyruara në këto certifikata nuk përfshijnë aktivitetin që lidhen me objektin e prokurimit, i cili ka të bëjë në vetvete me furnizim me pajisje mjekësore njëpërdorimëshe konkretisht letër rulo për nevoja spitalore.

Në këtë mënyrë, certifikatat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk përmbushin funksionin provues për të cilin është kërkuar duke mos garantuar në këtë mënyrë kapacitetin organizativ dhe teknik për realizimin e kontratës me sukses.

Në përfundim, KSHA gjykon se duke qenë se kushtet në lidhje me certifikimin duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe të plotë, mospërputhja materiale e fushës së certifikimit me objektin e prokurimit, çënon parimin e proporcionalitetit e për rrjedhojë mosplotësimi i këtij elementi nuk mund të konsiderohet si mangësi formale apo e korrigjueshme.

Për sa më lart, KSHA konstaton se Operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk nuk ka mundur të provojë përmbushjen e kriterit për paraqitjen e Certifikatës ISO 9001:2015 në përputhje materiale me objektin e prokurimit.

Për sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), si dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

- 1. Pranimin e plotë të ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik “FEDOS” shpk.*
- 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*
- 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.*
- 5. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”.*

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.

Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”.

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon shprehimisht se:

“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka

detyrimin të vëre menjëherë në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
- c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijëni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar i cili parashikon shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor dërguar me shkresën nr. 671/13 prot, datë 3.03.2026, protokolluar me tonën me nr. 916/4 prot, datë 01.04.2026, si dhe vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave pranë autoritetit kontraktor “Vendim KSHA 53/2026”, datë 31.03.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “FEDOS” SHPK, enti prokurues informon Komisionin e Prokurimit Publik, për trajtimin e ankesës me numër ankimi elektronik A/2026/6454, datë 25.03.2026 dhe numër protokoll nr. 916/2026, datë 25.03.2026 e operatorit ekonomik “FEDOS” SHPK, ku ka vendosur pranimin e plotë të saj.

KPP konstaton, se autoriteti kontraktor, ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimes, për procedurën e prokurimit objekt - shqyrtimi.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “FEDOS” SHPK.

III.2. Në datën 13.02.2026 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur” me numër reference Nr. REF-76050-02-12-2026, me objekt: “Blerje letër rulo për shërbimet, kabinetet dhe konsultat e QSUNT, për 24 muaj”, me fond limit 14,560,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.

III.2.1. Në datë 02.03.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.2.2. Në datën 13.03.2026 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

| | | | | |
|----|---|------------|------|--------------|
| 1 | “KRISTALINA.KH” sh.p.k | 0 | leke | skualifikuar |
| 2 | “Infosoft Office” sh.p.k | 9.698.000 | leke | kualifikuar |
| 3 | “FEDOS ” sh.p.k | 9.984.000 | leke | kualifikuar |
| 4 | “Carpathia Albania” sh.p.k | 9.999.600 | leke | kualifikuar |
| 5 | “Vitanet Albania” sh.p.k | 10.140.000 | leke | kualifikuar |
| 6 | “ISOMETRIC” sh.p.k | 10.660.000 | leke | kualifikuar |
| 7 | “Besim Kamberi” Person Fizik | 10.917.400 | leke | kualifikuar |
| 8 | “AN&RA” sh.p.k | 10.920.000 | leke | kualifikuar |
| 9 | “Biotek” sh.p.k | 10.920.000 | leke | kualifikuar |
| 10 | “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k | 10.920.000 | leke | kualifikuar |
| 11 | “Qendra e Monitorimit te Mjedisit” sh.p.k | 10.949.000 | leke | kualifikuar |
| 12 | “O.E.S DISTRIMED” sh.p.k | 11.440.000 | leke | kualifikuar |

| | | | | |
|----|--|------------|------|-------------|
| 13 | <i>“Malvina Visoka” Person Fizik</i> | 12.480.000 | leke | kualifikuar |
| 14 | <i>“Pastrime Silvio” sh.p.k</i> | 12.947.000 | leke | kualifikuar |
| 15 | <i>“MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k</i> | 14.561.000 | leke | kualifikuar |

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 19.03.2026 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues operatorin ekonomik *“InfoSoft Office” SHPK*.

III.2.4. Në datën **30.03.2026**, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6464, datë 30.03.2026 dhe numër protokoll nr. 966/2026, datë 31.03.2026 e operatorit ekonomik *“Besim Kamberi”* Person Fizik, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik *“InfoSoft Office” SHPK*, operatori ekonomik *“FEDOS” SHPK*, operatori ekonomik *“Carpathia Albania” SHPK*, operatori ekonomik *“Vitanet Albania” SHPK* dhe operatori ekonomik *“ISOMETRIC” SHPK*, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

III.2.5. Në datë 01.04.2026, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 671/15 prot, datë 01.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 966/1 prot, datë 01.04.2026, ku është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, *“Vendim KSHA 54/2026”*, datë 01.04.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues *“Besim Kamberi”* Person Fizik, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III.2.6. Në përputhje me nenin 112 *“Veprimet paraprake”* të Ligjit nr.162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 966/2, datë 01.04.2026 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues *“Besim Kamberi”* Person Fizik, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertave të paraqitura nga operatori ekonomik *“InfoSoft Office” SHPK*, operatori ekonomik *“FEDOS” SHPK*, operatori ekonomik *“Carpathia Albania” SHPK*, operatori ekonomik *“Vitanet Albania” SHPK* dhe operatori ekonomik *“ISOMETRIC” SHPK*, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

III.2.7. Me shkresën nr. 671/15 prot, datë 01.04.2026, protokolluar me tonën me nr. 966/3 prot, datë 03.04.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, *“Vendim KSHA 54/2026”*, datë 01.04.2026, për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues *“Besim Kamberi”* Person Fizik, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit.

III.2.8. Në datë 07.04.2026, operatori ekonomik ankimues “Besim Kamberi” Person Fizik ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dokumentin “*Informacion shtesë lidhur me ankesën nr. A/2026/6464*” protokolluar me tonën me numër nr. 966/4 prot, datë 07.04.2026, lidhur me vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave “*Vendim KSHA 54/2026*”, datë 01.04.2026, për pretendimet e paraqitura prej ankimuesit në ankesën me numër ankimi elektronik A/2026/6464, datë 30.03.2026.

III.2.9. Neni 24, pika 1, “*Komisioni i Prokurimit Publik*” i ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij. Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”.

III.2.10. Në nenin 111, pika 1 e Ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”. i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.2.11. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “*Afatet për ankimim*” i Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.12. Neni 112, pikat 1,2 dhe 3 të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*” i ndryshuar,, parashikon shprehimisht se:

“1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e

Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës).

3. Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, Komisioni i Prokurimit Publik publikon:

a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit;

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;

c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

III.2.13. Neni 113, i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë. Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.”.

III.2.14. Në nenin 114, pikat 1,4,5 dhe 6, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të

punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.

III.2.15. Neni 115, pika 1,2 dhe 3 i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji; c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të

interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”.

III.2.16. Në nenin 118, pika 2, germa “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se:

“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësisimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji.”.

III.2.17. Në Kreun II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 15.05.2024 “Për Përcaktimin e Kufijve Monetarë në Procedurat e Prokurimit Publik” parashikohet shprehimisht se:

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000

000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

III.2.18. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit përfundimtarë është 7 (shtatë) ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit paraprak ose publikimi i njoftimit të anulimit, për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.

Referuar përcaktimeve të Kreut II të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 291, datë 15.05.2024 “Për Përcaktimin e Kufijve Monetarë në Procedurat e Prokurimit Publik”, si dhe vlerës së fondit limit të përlllogaritur të procedurës së mësipërme të prokurimit objekt ankimi konstatohet se kjo procedurë prokurimi është procedurë prokurimi nën kufirin e lartë monetar.

Në rastin konkret, rezulton, se publikimi i njoftimit të të fituesit paraprak është kryer në datën 19.03.2026 në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE). Ndërkohë ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Besim Kamberi” Person Fizik e paraqitura pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik për vendimin përfundimtar të vlerësimit të ofertave të kualifikuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi është bërë më datë 30.03.2026 me

numër ankimi elektronik A/2026/6464, datë 30.03.2026 dhe numër protokoll nr. 966/2026, datë 31.03.2026 dhe është paraqitur jashtë afateve ligjore të ankimimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e mësipërme e operatorit ekonomik “Besim Kamberi” Person Fizik, për vendimin përfundimtar të vlerësimit të ofertave të kualifikuara në procedurën e prokurimit objekt-ankimi është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110 pika 2 e LPP, i cili parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe përfundon në ditën e 7-të në rastin e procedurave të prokurimit nën kufirin e lartë monetar ose ditën e 10-të në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufirin e lartë monetar. Në rastin konkret data e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është bërë në datën 19.03.2026, ndërkohë ankesa e paraqitura nga ankimuesi pranë autoritetit kontraktor dhe KPP është bërë në datën 30.03.2026, datë e cila rezulton të jetë jashtë afatit 7 (shtatë) ditor të përcaktuar në ligj, duke mos u legjitimuar racione temporis. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji stricto sensu ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesat e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 30.03.2026, nuk kanë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit sipas parashikimeve të LPP, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si lex specialis mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen e ankesës së operatorit ekonomik “*FEDOS*” SHPK në procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-76050-02-12-2026*, me objekt: “*Blerje letër rulo për shërbimet, kabinetet dhe konsultat e QSUNT, për 24 muaj*”, me fond limit 14,560,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Besim Kamberi*” Person Fizik në procedurën e prokurimit “*E hapur*” me numër reference Nr. *REF-76050-02-12-2026*, me objekt: “*Blerje letër rulo për shërbimet, kabinetet dhe konsultat e QSUNT, për 24 muaj*”, me fond limit 14,560,000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 13.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara Sh.A.
 3. Autoriteti kontraktor në zbatim të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “*Infosoft Office*” SHPK, si dhe të korrigjojë shkeljet, duke e skualifikuar këtë operator ekonomikë.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 5. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*FEDOS*” SHPK.
 6. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të pjesës së tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “*Besim Kamberi*” Person Fizik.
 7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

